



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 965 Prot.

Tiranë, më 10 / 07 / 2020

V E N D I M

Nr. 68, Datë 10 / 07 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.26 Regj., datë 15.04.2020, të F. Gj, kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), me pretendimin për diskriminim në formën e viktimizimit, ardhur si pasojë direkte e ankimit në gjykatë kundër UBT-së.¹

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, F. Gj shprehet se ka qenë në marrëdhënie pune si pedagog/lektor, me detyrën personel akademik “Profesor”, pranë Departamentit të Prodhimit Shtazor të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në UBT, që prej vitit 1989.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur procedimin penal nr.5005, datë 25.09.2013, në ngarkim të z.Gj si i dyshuar për veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Në përfundim të procedimit penal, Gjykata e Apelit Tiranë, nëpërmjet vendimit nr.2184, datë 15.10.2018, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr.2897, datë 25.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes për të pandehurin F. Gj”.

¹ Referuar kërkesës së subjektit ankues, depozituar pranë KMD-së, nëpërmjet e-mailit të datës 03.06.2020, protokolluar shkresërisht me nr.515/3 prot., datë 08.06.2020 pranë KMD.

Subjekti ankues, pas shpalljes së vendimit të formës së prerë, nëpërmjet shkresës me nr.2591 prot., datë 23.11.2018, i është drejtuar Rektorit të UBT-së, duke i kërkuar që të rikthehej në punë, pasi pengohej nga Urdhëri i pezullimit, (nxjerrë nga Rektori deri në përfundim të procesit gjyqësor, lidhur me procesin penal në ngarkim të ankuesit).

Ndërkaq, nëpërmjet shkresës me nr.2914/4, datë 19.12.2019 “Urdhër nr.102”, të Rektorit të UBT, ankuesi është njoftuar për nisjen e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e UBT, për shkak të prezumimit të tij si i fajshëm për veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, pa vendim gjykate të formës së prerë. Po ashtu, z.Gj pretendon se është viktimizuar për shkak të ankimimit në gjykatë të urdhërit të pezullimit të tij, nga ana e Rektorit të UBT.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij në formën e viktimizimit nga ana e Rektorit të UBT, ardhur si pasojë direkte e ankimimit të tij në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë².

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi³”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

² Referuar kërkesës së subjektit ankues, depozituar pranë KMD-së, nëpërmjet e-mailit të datës 03.06.2020, protokolluar shkresërisht me nr.515/3 prot., datë 08.06.2020 pranë KMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr.515/1 prot., datë 27.04.2020, KMD ka njoftuar UBT lidhur me pretendimet e ankuesit si dhe i ka kërkuar informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm provues.
- Nëpërmjet shkresës me nr.714/1 prot., datë 21.05.2020 UBT-ja, informon Komisionerin si më poshtë vijon:

“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.5005, datë 25.09.2013, për F. Gj, si person i dyshuar për veprën penale të “korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe më pas i ka kërkuar gjykatës vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin si masë sigurimi atë të “arrestit me burg”. Në po këtë datë, më 03.10.2013, kjo masë sigurie është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore dhe paditësi është paraburgosur.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr.1075, datë 07.10.2013, ka vendosur vlerësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe ka caktuar ndaj paditësit masën e sigurimit “arrest shtëpie”, e cila me Vendimin nr.689, datë 07.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë është lënë në fuqi.

UBT për shkak të nisjes së procedimit penal në ngarkim të F. Gj nxori Urdhrin nr.84, datë 04.10.2013 “Për pezullimin e tij pa afat të caktuar, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe marrjen e një vendimi të formës së prerë nga ana e organeve gjyqësore.

Në përfundim të gjykimit të çështjes penale, Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin nr.1106, datë 04.06.2015 ka vendosur lënien në fuqi të datës 25.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka dënuar F. Gj për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

Në kontratën individuale të punës ndërmjet F. Gj dhe UBT, në nenin 9 përcaktohen rastet e largimit nga puna të punëmarrësit, ku thuhet se: “Personeli akademik largohet nga puna...kur dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës me heqje lirie”. ”.

UBT vijon me argumentimin se, nga momenti që nga gjykata e shkallës së parë është vendosur dënimi me dy vjet burgim, dhe po nga Gjykata e Apelit është lënë në fuqi ky vendim, marrëdhënia e punës nuk mund të vazhdojë, duke cituar se:

- Neni 462, pika b) e Kodit të Procedurës Penale përcakton se vendimet e Gjykatës së Apelit janë të ekzekutueshme menjëherë pasi kanë marrë formë të prerë, dhe
- Bazuar në nenin 154, pikat 2 dhe 3 të Kodit të Punës citojnë se UBT ka patur shkak të ligjshëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me F. Gj.

UBT sqaron se, z.Gj në përfundim të procesit gjyqësor nuk ka përmbushur detyrimin e informimit për të gjitha faktet e ndryshimet të cilat ishin të rëndësishme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj punëdhënësit. Ai ka ndjekur rrugën gjyqësore duke depozituar kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër UBT me objekt “Heqje të Urdhrit të pezullimit nga puna dhe rikthim në detyrë”, për të cilën ajo është shprehur nëpërmjet Vendimit nr.7563, datë 11.11.2019. UBT e ka ankimuar këtë vendim gjyqësisht.

UBT parashtroi se: *“F. Gj ka konsumuar afatet për ushtrimin e të drejtave ndaj punëdhënësit sepse afati i parashkrimit për të ushtruar të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit në rrugë gjyqësore është 3 vjet. Po kështu, z.Gj nuk figuron prej vitesh në strukturën organizative dhe strukturën analitike të pagave. Në Departamentin e Prodhimit Shtazor pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit në strukturën e tij organike për vitin 2019, vendi, i cili përkonte më parë me ish-pozicionin e punës të F. Gj është suprimuar”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në vlerësim të pretendimeve të ankuesit, Komisioneri ka çmuar të shqyrtojë dhe analizojë kërkesën e F. Gj, lidhur me pasojat e ardhura menjëherë pas ankimimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, ku ndër të tjera ka kërkuar, heqjen e Urdhrit të pezullimit të tij nga detyra dhe rikthimin në detyrë.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë,

por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁴

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁵ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s⁶ që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos këtë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrojnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane⁷ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arrijten e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht”*.

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim...”*.

Në këtë kuadër, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar⁸, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, gërma c) parashikohet se: *“Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:*

⁴ https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discri_laë_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁶ International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

⁷ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

⁸ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelje të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente”.

Kodi i Punes, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së⁹. Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Pretendimi i subjektit ankues se shkak për diskriminimin ndaj tij është fakti se ai ka paraqitur një ankim kundër UBT-së në gjykatë, përbën një nga format e diskriminimit, që gëzon mbrojtje sipas nenit 3/8 të LMD-së.

A) Lidhur me pretendimin e ankuesit për viktimizim, ardhur si pasojë e ankimit të tij në gjykatë.

Bazuar në deklaratimet e palëve në proces dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues, F. Gj, ka qenë në marrëdhënie pune si pedagog/lektor, pranë Departamentit të Prodhimit Shtazor, të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, pranë UBT. Ai shprehet se marrëdhënia e tij e punës me UBT daton që nga viti 1989. Kjo marrëdhënie pune rezulton e formalizuar nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës me nr.205 prot., datë 08.10.2012, në të cilën ankuesi caktohet të punojë në detyrën personeli akademik “Profesor”, pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, kontatë kjo e lidhur më datë 30.05.2012 dhe e vlefshme për një periudhë kohore pa afat.

⁹ Referuar nenit 3, pika 8,e LMD-së.

Ndaj subjektit ankues, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 03.10.2013, ka vendosur ndalimin, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe më pas i ka kërkuar Gjykatës vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, masë e cila është ekzekutuar brenda kësaj date, më 03.10.2013 nga Policia Gjyqësore dhe z.Gj është paraburgosur.

Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr.1075, datë 07.10.2013, ka vendosur “vlerësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë” dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, masë e cila është lënë në fuqi nëpërmjet Vendimit nr.689, datë 07.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndërkaq, nga ana e UBT, për shkak të nisjes së procedimit penal në ngarkim të z.Gj, nëpërmjet Urdhrit nr.84, datë 04.10.2013 është urdhëruar pezullimi i tij pa afat të caktuar, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe marrjen e një vendimi të formës së prerë nga ana e organeve gjyqësore.

Pas gjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr.2897, datë 25.11.2014, ka vendosur deklarinin fajtor të F. Gj, për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me dy vjet burg.

Ky vendim është ankimuar nga subjekti ankues në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr.1106, datë 04.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti ankues ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Referuar Urdhrit të lirimit, të datës 21.01.2016 të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë, F. Gj rezulton se është liruar më datë 21.01.2016, për shkak “Amnistie”.

Ndërkaq, pas rekursit të bërë në Gjykatën e Lartë nga subjekti ankues kundër Vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e Lartë, nëpërmjet Vendimit nr.2, datë 18.01.2017, ka vendosur prishjen e Vendimit nr.1106, datë 04.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e akteve për rishqyrtim po pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Apelit Tiranë, nëpërmjet Vendimit nr.2184, datë 15.10.2018 ka vendosur pushimin e çështjes për F. Gj.

Në këto kushte, bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit, i cili, *inter alia*, arsyeton se: “Në të tilla rrethana nuk provohet se i pandehuri F. Gj të ketë kryer veprën për të cilën akuzohet, me prova që e provojnë atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe për rrjedhojë vendimi për këtë të pandehur duhet të priset dhe çështja të pushohet.”, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për kompensim për burgim të padrejtë bazuar në pafajësinë e tij. Kjo Gjykatë nëpërmjet Vendimit nr.3943, datë 14.11.2019, ka vendosur detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë F. Gj shumën e kërkuar, si kompensim për periudhën e burgimit të padrejtë të kryer prej tij.

Subjekti ankues, bazuar në faktin që, pas rigjykimit të çështjes së tij, Gjykata e Apelit kishte vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të tij, duke e gjetur të pafajshëm atë për veprën e akuzuar (faktuar në vijim dhe nga vendimi i përfitimit të dëmshpërblimit për burgim të padrejtë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë), nëpërmjet kërkesës datë 31.10.2018, protokolluar pranë UBT, me shkresën me nr.2591 prot., datë 23.11.2018¹⁰, i ka kërkuar punëdhënësit, UBT-së, heqjen e Urdhrit të pezullimit dhe rikthimin e tij në detyrën e mëparshme, pasi tanimë shkaku i pezullimit të tij nga detyra, i nxjerrë nga ky institucion, kishte rënë me vendim të formës së prerë.

Duke qenë se subjekti ankues nuk mori përgjigje lidhur me kërkesën e datës 23.11.2018, iu drejtua sërisht UBT-së, nëpërmjet kërkesës së datës 20.02.2019.

Ndërkaq, duke mos patur asnjë përgjigje zyrtare nga ana e UBT-së, lidhur me kërkesat e tij, subjekti ankues, me datë 08.04.2019 paraqet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesë padinë kundër punëdhënësit, UBT, me objekt: *“Heqjen e Urdhrit të pezullimit të tij nga detyra. Detyrimin e të paditurit ta rikthejë në detyrë. Detyrimin e të paditurit që ta paguajë nga data 04.10.2013 e deri në rikthimin në detyrë, përfshi dhe pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”*.

Nëpërmjet Vendimit nr.7563, datë 11.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së z.Gj dhe detyrimin e palës së paditur, UBT-së, për t'i paguar paditësit pagat e pamarrë nga data 04.10.2013 e në vazhdim përfshirë edhe pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky vendim është në proces gjyqësor, pasi është apeluar nga pala e paditur, UBT.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve, rezulton e provuar se:

- Bazuar në shkresën me nr.60 prot., datë 11.12.2019, UBT ka marrë dijeni për Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipër cituar, me datë 10.12.2019.
- Menjëherë, pas komunikimit të këtij vendimi, UBT nëpërmjet Urdhrit nr.102, datë 19.12.2019¹¹, ka filluar procedurën e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me F. Gj, duke parashtruar si shkaqe të arsyeshme:
 - a) Është ndaluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe në vijim është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë;
 - b) Nuk figuron prej vitesh në strukturën organizative dhe strukturën analitike të pagave;
 - c) Nuk ka vend vakant apo të lirë në strukturën organike të vitit 2019, pranë Departamentit të Prodhimit Shtazor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, vend i cili përkonte me ish-pozicionin e punës të F. Gj;

¹⁰ Ankuesi i ka bashkëlidhur kërkesës edhe një kopje të Vendimit nr.2184, datë 15.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹¹ Shkresa me nr.2914/4 prot., datë 19.12.2019 e UBT-së.

- d) Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, nuk kanë vazhduar nga momenti që Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur dënimin e tij dhe po nga Gjykata e Apelit është lënë në fuqi ky vendim;
- e) Nuk mund të lihet pozicioni i punës vakant në një Institucion të rëndësishëm, siç është UBT, për një periudhë të gjatë kohore, nga koha në të cilën F. Gj ka vuajtur dënimin.

Pra, për sa i takon pasojave negative në marrëdhëniet e punësimit të z.Gj, nga ana e punëdhënësit, rezulton e provuar se në rend kronologjik ato kanë ardhur menjëherë pas ankimit të tij në gjykatë për heqjen e Urdhrit të pezullimit dhe kërkesës për rikthim në detyrë. Menjëherë pas komunikimit të Vendimit sipër cituar të gjykatës, UBT ka iniciuar procedurën e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me F. Gj.

Sa i takon analizimit të zgjidhjes së Kontratës Individuale të punës të ankuesit nga ana e UBT, Komisioneri vlerëson se:

- Deri në momentin e komunikimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipër cituar, me datë 10.12.2019, ankuesi vijonte të ishte i pezulluar nga ana e UBT dhe marrëdhënia e punës me këtë institucion vijonte sipas kushteve të përcaktuara në Kontratën Individuale të Punës të formalizuar me shkresën me nr.205 prot., datë 08.10.2012.
- Nëpërmjet Urdhrit nr.84, datë 04.10.2013, UBT kishte urdhëruar pezullimin e ankuesit pa afat të caktuar, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe marrjen e një vendimi të formës së prerë nga ana e organeve gjyqësore.
- Gjatë periudhës kohore të pezullimit, ankuesit në asnjë rast nuk i është njoftuar apo komunikuar ndonjë vendim apo akt administrativ për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës.
- Referuar: Vendimit nr.2184, datë 15.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për F. Gj dhe Vendimit nr.3943, datë 14.11.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur kompensimin monetar të ankuesit, për periudhën e burgimit të padrejtë të kryer prej tij; Komisioneri vlerëson se për sa më sipër, shkaku i pezullimit nga detyra për subjektin ankues ka rënë.

Neni 44 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.*

KEDNJ në nenin 13 të saj ka sanksionuar se: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në KEDNJ, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare”.*

Po ashtu, jurisprudenca e GJEDNJ ka konsoliduar këtë parim, duke u shprehur se, nëse ajo konstaton në një gjykim një shkelje të tillë, detyron shtetin respektiv nëpërmjet detyrimit ligjor

për t'i dhënë fund shkeljes dhe të dëmshtëpërblejë pasojat e saj në mënyrë të tillë, që të rivendosë sa më shumë të jetë e mundur situatën ekzistuese para shkeljes *“restitution in integrum”*.

Po ashtu, fryma në parim dhe përcaktimet specifike të Kodit të Punës¹², përderisa pezullimi nga puna i ankuesit është bërë për arsye të pavarura nga ai, kanë parashikuar se: *“Nëse punëdhënësi refuzon të zërë me punë punëmarrësin, për një arsye që nuk lidhet me të, ai detyrohet të paguajë punëmarrësin edhe kur nuk vazhdon të punojë”*.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe UBT konsiderohet se duhet të vijonte sipas kushteve të Kontratës Individuale të Punës, e cila ishte ende në fuqi, e drejtë e cila buron *ipso lege*.

- Masa e pezullimit nga detyra ndaj ankuesit, në vetvehte ishte një masë e përkohshme që lidhej me një shkak konkret, atë të fillimit të procedurave të ndjekjes së tij penale për shkak të dyshimit të veprës penale të “korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”. Pezullimi në vetvehte paraqet largimin e përkohshëm nga detyra si rezultat i disa rrethanave të prezumuara të cilat priten të vërtetohen apo jo. Në këto kushte, i punësuar i ruan të drejtën e kthimit në detyrë, me largimin apo mosprovimin e atyre rrethanave.
- Në këto kushte, Komisioneri, çmon se, punëdhënësi, pas kërkesave të përsëritura të ankuesit dhe bazuar në vendimin e formës së prerë nr.2184, datë 15.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të kishte vijuar me heqjen Urdhërit të pezullimit ndaj ankuesit dhe zënien e tij me punë, bazuar në kushtet e Kontratës Individuale të Punës me të, e cila vijonte të ishte në fuqi akoma. Kjo për arsye se konflikti ka gjeneruar jo për shkak të zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës të ankuesit me UBT, por për shkak të mosheqjes së masës së pezullimit të tij nga puna.
- Komisioneri gjykon se, argumentimi i UBT se, si shkak i ligjshëm për të zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës me ankuesin ka shërbyer vendimi i formës së prerë me nr.1106, datë 04.06.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi Vendimin nr.2897, datë 25.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet të cilit është vendosur deklarimi fajtor i F. Gj për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe dënimin e tij me dy vjet burg”; është jo vetëm i gabuar, i pabazuar por dhe i qëllimshëm e tendencioz ndaj ankuesit për këto arsye:
 - a) UBT i është referuar vendimit sipër cituar në mënyrë të gabuar dhe të pabazuar për faktin se ky vendim është prishur nga Gjykata e Lartë¹³ dhe për rrjedhojë ai nuk sjell asnjë pasojë apo efekt juridik.
 - b) Referimi tek zbatimi i këtij vendimi nga ana e UBT përveçse i gabuar është dhe i qëllimshëm dhe tendencioz, pasi nëse UBT do ta zbatonte atë, duhet të kishin vepruar që pas shpalljes së tij nga gjykata, më datë 04.06.2015 dhe nuk kishte si dhe pse të zbatonin

¹² Neni 129 i K.Punës.

¹³ Vendimi nr.2184, datë 15.10.2018 i GjL.

pikërisht këtë vendim, pas katër vitesh¹⁴. Kjo, pasi me datë 15.10.2018, Gjykata e Lartë e kishte kthyer atë për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me datë 15.10.2018 është shprehur qartë lidhur me rastin e F. Gj.

- c) UBT kishte dijeni për këtë vendim, pasi vetë ankuesi i ka vënë në dijeni, nëpërmjet kërkesës së tij, fillimisht me datë 23.11.2018.
- d) Edhe pse UBT kishte ardhur në dijeni të vendimit të formës së prerë të datës 15.10.2018, shprehet në mënyrë kontradiktore dhe haptazi të pabazuar se ka zbatuar një vendim të para 4 viteve, i cili nuk kishte asnjë efekt juridik, pasi ishte prishur nga Gjykata e Lartë.
- e) UBT përveçse referon në mënyrë të gabuar zbatimin e vendimit të formës së prerë për ankuesin, ka paragjykuar haptazi atë lidhur me përcaktimin si fajtor për një vepër penale, për të cilën me vendim gjyqësor të formës së prerë është shpallur i pafajshëm dhe për më tepër, edhe është dëmshtëpërblyer për burgim të padrejtë.
- f) Vendimi nr.2184, datë 15.10.2018 i Gjykatës së Apelit Tiranë është i qartë dhe nuk lë asnjë vend apo mundësi për interpretim, lidhur me faktin e pafajësisë së subjektit ankues.
 - Nga ana e UBT nuk rezulton të jetë provuar deri në këto momente¹⁵ që kontrata e punës të ishte zgjidhur apo që vendi i punës i ankuesit të ishte suprimuar.
 - Përkundrazi, ata kanë argumentuar faktin se pozicioni i punës që ankuesi mbante, për vetë rëndësinë e tij, nuk mund të mbetej vakant.
 - Pretendimi që ky pozicion është suprimuar është ngritur nga ana e UBT vetëm, pasi ankuesi ka ankimuar në gjykatë dhe ata kanë marrë dijeni për Vendimin nr.7563, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga njëra anë UBT shprehet se, për rëndësinë që ky pozicion mbante nuk mund të mbetej vakant, dhe pastaj që ky pozicion, megjithëse deri atëherë vlerësohej i asaj rëndësie sa të mos lihej vakant, rezulton të jetë suprimuar. Komisioneri gjykon se, UBT është kontradiktore në këtë deklaram.
 - Fakti i suprimimit të këtij pozicioni bëhet prezent vetëm në Urdhrin nr.102, datë 19.12.2019 të UBT nëpërmjet të cilit urdhërohet fillimi i procedurës së zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me F. Gj, procedurë e cila ka konkluduar me Vendimin nr.16, datë 12.03.2020 për ndërprerjen e kontraktuale të punës ndërmjet UBT dhe ankuesit.
 - Për më tepër, Komisioneri konstaton se kjo procedurë është iniciuar mbas datës 10.12.2019, mbasi UBT i është komunikuar Vendimi nr.7563, datë 11.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo provohet nëpërmjet shkrësës me nr.60 prot., datë 11.12.2019, të UBT në të cilën Sektori Jurik i drejtohet Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, duke cituar se: *“Më datë 10.12.2019 na është komunikuar vendimi i Gjykatës në të cilin është vendosur detyrimi i UBT për t’i paguar paditësit pagat e pamarra nga data 04.10.2013 e në vazhdim, përfshirë edhe pagesën për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Në mënyrë që të ndërpritet detyrimi financiar në vazhdim ndaj palës paditëse duhet të merren masa për të bërë procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të paditësit F. Gj, duke iu referuar Kodit të Punës”.*

¹⁴ Referuar Urdhrit nr.102, datë 19.12.2019 të UBT.

¹⁵ Deri në daljen e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, me nr.2184, datë 15.10.2018.

- Bazuar në përmbajtjen e kësaj shkrese, rezulton se ankuesi ka qenë në marrëdhënie kontraktuale pune me UBT, fakt i pranuar dhe prej tyre. Po ashtu, faktohet se UBT do të iniciojë procedurën e ndërprerjes së këtyre marrëdhënieve kontraktuale, pikërisht që ata të mos detyroheshin të kishin kosto të tjera financiare ndaj ankuesit, gjë që hedh poshtë pretendimin se ata po zbatonin vendimin e formës së prerë të datës 04.06.2015, i cili *de jure* nuk prodhonte asnjë efekt apo pasojë juridike.

Përfundimisht, në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e UBT subjektit ankues i është cënuar e drejta për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës që ai mbante, për sa kohë është provuar se nisja e procedimit penal kundrejt tij ishte e padrejtë dhe shkak për të cilin kishte iniciuar kishte rënë. Në këto rrethana kjo e drejtë e cënuar duhet të ishte rivendosur nga ana e UBT.

Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët, lidhur me një shkak të caktuar. Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - "*praesumptio iuris tantum*".

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime "*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁶".

Kodi i Procedurës Administrative, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast UBT, i cili duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, si pasojë e ankimit të tij në gjykatë.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: "*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*".

¹⁶ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁷ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Sa më sipër, personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti (nga i cili pretendohet diskriminimi), i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga UBT kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, UBT duhet të provonte se pretendimi i ankuesit ishte i pabazuar në fakte e prova dhe se veprimet e tyre ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale, të arsyeshme dhe të justifikuara objektivisht.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e UBT nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit nuk kanë ndodhur pas ankimimit të tij në gjykatë, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuara dhe objektive.
- Përkundrazi, bazuar në shkresën me nr.60 prot., datë 11.12.2019, u provua e kundërta: UBT ka marrë dënimin për Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipër cituar, me datë 10.12.2019.
- Menjëherë, pas komunikimit të këtij vendimi, UBT nëpërmjet Urdhrit nr.102, datë 19.12.2019¹⁸, ka filluar procedurën e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me F. Gj.

Pra, siç shihet qartë nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektit ankues nga ana e UBT, i kanë ardhur menjëherë pas ankimimit të tij në gjykatë dhe shprehjes së kësaj të fundit me vendim.

Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: *“trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”*.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon dyshimin e arsyeshëm dhe vlerëson se F. Gj, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e ankimit të tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁹ e cila nëpërmjet Vendimit nr.7563, datë 11.11.2019 ka vendosur detyrimin e UBT për t’i paguar

¹⁷ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁸ Shkresa me nr.2914/4 prot., datë 19.12.2019 e UBT-së.

¹⁹ Për analogji citojmë Vendimin nr.177, datë 16.12.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

z.Gj pagat e pamarra nga data 04.10.2013 e në vazhdim, përfshirë edhe pagesën për kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 12, pika 1, germat c), nenit 13, pika 1, germa a), nenit 8, pika 8, nenit 32, germa c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të F. Gj nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), për shkak të ankimimit të tij në Gjykatë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Diskriminim në formën e viktimizimit për shkak të ankimimit në Gjykatë